
AKT THEMELIMI

"GREEN LINE TIRANA" SHPK

*Unë, Ylli Beqiri i angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë **27/11/2018**, shpreh vullnetin e tim të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:*

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.

Emri i shoqërisë do të jetë "**GREEN LINE TIRANA**" SHPK, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortakët e shoqërisë.

Ortak i vetëm i shoqërisë është:

- **Ylli Beqiri, shtetas amerikan, i datëlindjes 09.12.1969, identifikuar nga pasaporta me nr. 493919775.**

3. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- ***Shërbime të transportit publik nëpërmjet makinave, autobuzëve dhe/ose taksive elektrike;***
- ***Import-eksport i makinerive/pajisjeve elektrike;***
- ***Qendra të specializuara për rakarikimin/rimbushjen elektrike të makinerive, makinave, autobuzëve dhe/ose taksive elektrike;***

-
- ***Prodhim i makinerive elektrike, duke përfshirë por pa u kufizuar në, makina dhe autobuzë elektrikë si dhe ndërtimi i linjave teknologjike respektive;***
 - ***Prodhim i paneleve diellore si dhe i sistemeve të tjera të energjisë së rinovueshme.***

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë.

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rr. "Adem Jashari", Pall. 10/1, Shk. 1, Ap. 4, Tiranë.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Kapitali themeltar.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 10.000 (dhjetë mijë lekë).**

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.

-
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administratori i parë shoqërisë do të jetë:
 - **Z. Agim Tutulani**, shtetas shqiptar, i biri i Nikos, lindur në Tiranë, më 15.03.1982, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 029249040, me nr. personal I20315265E.

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKU I VETËM

YLLI BEQIRI

Ylli Beqiri
YB